



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:267603

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06179776

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bekim Salihu, me praktikanten Altinë Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve G. D. nga Ferizaj, F.T.M. nga Ferizaj, M.Z. nga Ferizaj, L.H. nga Ferizaj dhe S.S. nga Ferizaj, të cilët i përfaqëson av. Dardan Hakiu nga Ferizaj, kundër të paditurës Spitali Rajonal Ferizaj me seli në Ferizaj rr. "Ramadan Rexhepi", me objekt kontesti kompensim i pagave të 13-ta (trembëdhjeta), jashtë seancës gjyqësore me datë 17 Shtator 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve G.D. nga Ferizaj, F. T.M. nga Ferizaj M.Z. nga Ferizaj, L.H. nga Ferizaj dhe S.S. nga Ferizaj, ashtu që **DETYROHET** e paditura Spitali Rajonal Ferizaj, që paditësve:

**-G.D.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2020 t'ia paguaj në shumën e përgjithshme **565.00€ (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro)**,

**-F.T.M.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2020 t'ia paguaj në shumën e përgjithshme **377.00€ (treqind e shtatëdhjetë e shtatë euro)**,

**-M.Z.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2020 tia paguaj në shumën e përgjithshme **425.00€ (katërqind e njëzet e pesë euro)**,

**-L.H.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2020 tia paguaj në shumën e përgjithshme **425.00€ (katërqind e njëzet e pesë euro)**, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë me data 05.12.2023 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në shumë prej **280.00€**, të gjitha këto afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

**II. REFUZHET** kërkesë padia për paditësen **S.S.** për kompensimin e pagave të 13 – ta për vitin 2021 në shumën prej 471.1€ dhe vitin 2022 në shumën prej 471.14€ në shumë të përgjithshme prej 942.24€ (nëntëqind e katërdhjetë e dy euro e njëzet e katër cent) si e pabazuar.

**III. REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesë padisë për kompensimin e pagave të 13 – ta për vitet 2018 dhe 2019 në shumën prej 3,145.49€ (tremijë e njëqind e katërdhjetë e pesë euro e katërdhjetë e nëntë cent) si dhe paga e 13-të për vitet 2021 dhe 2022 në shumën prej 4,602.90€ (katërmijë e gjashtëqind e dy euro e nëntëdhjetë cent), si e pabazuar.

### **A r s y e t i m**

Paditësit përmes të autorizuarve të tyre, me datën 05.12.2023, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Spitali Rajonal Ferizaj, me të cilën ka kërkuar pagesën e pagave të 13-ta, për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Më tej, në padi kanë theksuar se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune në SHSKUK-Spitali Rajonal-Ferizaj, si në vërtetimet e bashkangjitura dhe që nga ajo kohë vazhdojnë të jenë të punësuar në këtë institucion në pozitat e njëjta, paditësi G. D. në pozitën Psikologe, paditësja F.T.M. në pozitën Infermiere, paditësja M.Z. në pozitën Inkasante-Administratore, paditësja L.H. në pozitën Teknike laborante dhe S.S. në pozitën Laborante. Paditësit edhe pse janë të punësuar në këtë institucion dhe kanë kryer gjithmonë në përpikëri detyrat e tyre të punës, kanë marrë gjithmonë vlerësime të kënaqshme dhe ndonëse grada dhe kualifikimi i përvojës së punës i njeh të drejtën në shpërblim të një page bazë në fund të vitit, të cilat i parasheh Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë me numër nr. 01-05-3815 e datës 12/06/2018 i cili në nenin 17 par. 2 thekson „ Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, një gjë e tillë nuk është realizuar. Paditësit kanë tentuar që përmes rrugëve jashtëgjyqësore të bëjnë realizimin e të drejtës së tyre në marrjen e kompensimit në emër të një page të 13-të, përmes kërkesës drejtuar të paditurës, mirëpo deri më tani nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët me të paditurën, andaj duke u gjendur pranë kësaj situatë, paditësit përmes të autorizuarve të tyre janë detyruar ti drejtohen kësaj gjykate që të drejtën e tyre ta realizojnë përmes rrugëve gjyqësore. Andaj kanë kërkuar që të aprovohet padia dhe kërkesë padia e Paditësve si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi, e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit, me arsyetimin se paditësi ka kërkuar që e paditura të ia kompensoj pagat e trembëdhjeta duke u mbështetur në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, e cila kontratë ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më 10.06.2021 e këtë gjë e vërteton edhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme, më tutje ka shtuar se padia e është e pathemeltë për faktin se me nenin 17 paragrafi 2 të KKS është përcaktuar se *‘‘Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë gjithnjë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit’’*, andaj bazuar në këtë dispozitë ligjore si dhe në mendim juridik të gjykatës supreme, është paraparë dhe kushtëzuar vetëm sa u përket mundësive buxhetore të punëdhënësit. Andaj ka kërkuar që nga të theksuarat gjykata të merre aktgjykim dhe ta refuzoj padinë e paditësve si të pa bazuar në prova dhe fakte.

Për më tepër e paditura është thirrur edhe në parashkrimin e kërkesave të paditësit sa i përket nenit 87 të Ligjit të Punës dhe nenit 341 dhe 342 të LMD-së. Andaj ka kërkuar që nga të theksuarat gjykata të merre aktgjykim dhe ta refuzoj padinë e paditësve si të pa bazuar në prova dhe fakte. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadija e paditësve është e themeltë.

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqës, konstaton se në mes tyre është kontestuese baza juridike e kërkesëpadiës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqës nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë fakt e vërtetoi sipas vërtetimeve të punësimit të paditësve të bashkangjitura në shkresa të lëndës.

Nga Kontratat e Punës për punësim në kohë të pacaktuar dhe lista e pagave të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, gjykata ka vërtetuar se paditësit janë të punësuar me orar të plotë në

Spitalin Rajonal Ferizaj për kohë të pacaktuar dhe për periudhën 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ku edhe vazhdojnë të punojnë.

Bazuar në provat e bashkangjitura në padi, gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si dhe dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë me numër nr. 01-05-3815 e datës 12/06/2018. Po ashtu bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, për shpërblimin e pagës së 13-të, të punëtorëve të shëndetësisë. Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Në nenin 20 par.2 të Ligjit nr. 04/l-125 për shëndetësi përcaktohet se: *“Institucionet e kujdesit shëndetësor që nuk janë pjesë e organizatës shëndetësore nga neni 68 i këtij ligji, në komunat ku kujdesi dytësor shëndetësor zbatohet në bazë të legjislacionit përkatës për vetëqeverisjen lokale, do të kenë kompetenca të zgjeruara për ofrimin e kujdesit shëndetësor sekondar, përfshirë këtu: Punësimin dhe pagesën e pagave dhe mëditjeve në pajtim me legjislacionin në fuqi”*.

Ndërsa neni 77 të këtij ligji përcakton se: *“Të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës e profesionistëve shëndetësorë si dhe kushtet e tyre të punës rregullohen me këtë ligj, ligjin e punës, dhe aktet e tjera ligjore në fuqi”*, ndërkaq bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, për shpërblimin e pagës së 13-të, për punëtorët e shëndetësisë është paraparë se *“Punëtorët shëndetësor në kontestet nga marrëdhëniet e punës me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12/06/2018, kanë të drejtë në kompensimin e pagës së 13-të për çdo vite kalendarik, në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve G.D. si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 në lartësinë e pagës bazë prej 565.00€ për çdo fundvit dhe atë për vitin 2020, F.T.M. si e punësuar pranë saj që të ia paguajë pagën e 13 në lartësinë e pagës bazë prej 377.00€ për çdo fundvit dhe atë për vitin 2020 M.Z. si i punësuar pranë saj që të ia paguajë pagën e 13 në lartësinë e pagës bazë prej 425€ dhe L.H. si i punësuar pranë saj që të ia paguajë pagën e 13 në lartësinë e pagës bazë prej 425€ dhe atë bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale. Nga interpretimi i dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale, të nxjerra nga e paditura dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses sa i përket pagave të 13-ta është pjesërisht e bazuar sepse

paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik, ta përfitoj si shpërblim, një pagë bazë në fund të vitit kalendarik përkatës.

Sa i përket pjesës refuzuese në dispozitivin e dytë për paditësen S.S., gjykata vlerësoj se nuk ka bazë për konpenzimin e pagës së 13-të për të njëjtën pasi që e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune në periudhën e vitit 2021 dhe 2022, gjykata të njëjtën e ka vendosur në përputhje me nenin 399 paragrafi 1 të LPK-së, pasi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë me numër nr. 01-05-3815 e datës 12/06/2018 e cila ka hyrë në fuqi më datë 10.06.2018 ka pasur vlefshmëri për 3 (tri) vite respektivisht deri më 10/06/2021, andaj kërkesa e paditësit për vitin 2021 dhe për vitin 2022, gjykata ka gjetur se nuk kanë bazë ligjore për aprovim andaj si të tillë e ka refuzuar.

Gjykata sa i përket kërkesë së paditësve, për kompensimin e pagave të 13-ta për vitet 2018, 2019, bazuar edhe në prapësimet e paraqitura nga e paditura, ku e njëjta është thirrur në parashkrimin e kërkesave për këto vite, këto pretendimet të paditurës i ka gjetur si të bazuar, andaj dhe këtë pjesë të kërkesëpadisë e ka refuzuar sikurse në pikën III të dispozitivit pasi që kërkesa e paditësit për kompensimin e pagës së 13-të për vitin 2018 dhe 2019 pasi që për këtë pjesë ka arritur afatin e parashkrimit, pra kërkesa e paditësit për këto vite është paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor me të cilin paditësit do të mund të gëzonte mbrojtje gjyqësore, pasi që i njëjti padinë e ka paraqit me datë 05.12.2023 dhe atë bazuar në nenin 82 të Ligjit të Punës 03/L-212, i cili është në fuqi parashihet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*

Ndërsa sa i përket pjesës tjetër refuzuese dhe atë për kompensimin e pagave të 13-ta për vitin 2021 dhe 2022, gjykata të njëjtën e ka vendosur në përputhje me nenin 399 paragrafi 1 të LPK-së, pasi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë me numër nr. 01-05-3815 e datës 12/06/2018 e cila ka hyrë në fuqi më datë 10.06.2018 ka pasur vlefshmëri për 3 (tri) vite respektivisht deri më 10/06/2021, andaj kërkesa e paditëses S.S., për vitin 2021 dhe për vitin 2022, gjykata ka gjetur se të njëjtat nuk kanë bazë ligjore për aprovim andaj si të tillë e ka refuzuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi sa i përket pjesëve të aprovuara të kërkesë padisë dhe gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendimin se detyrimet financiare nga Kontrata Kolektive Sektoriale se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi ndarjet buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast detyrimi nga neni 17 i Kontratës Kolektive Sektoriale,

janë aprovuar nga struktura të larta të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në mos ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat lartcekura, përderisa e paditura me asnjë provë shkresore – analizë buxhetore, nuk e ka argumentuar faktin se nuk ka pasur mundësi buxhetore apo se ka bërë kërkesë për buxhet të veçantë për aprovimin e pagave të 13-ta për punonjësit e saj si është e paraparë në kontratë Kolektive të nënshkruar nga vetë Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Shëndetësisë dhe e jo të arsyetohet me arsyetim të pa argumentuar se nuk ka pasur mundësi buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit për pjesën e aprovuar të kërkesës, për më tepër sa i përket mundësive buxhetore të të paditurës paditësit ka dorëzuar edhe raportin e auditimit për vitet përkatëse dhe nga e njëjta vërtetohet se e paditura ka pasur mundësin e përmbushjes së këtij detyrimi tek paditësit, por të njëjtin detyrim nuk e ka përmbushur.

Gjykata po ashtu morri parasysh dhe vlerësoi pretendimet e palës së paditur se baza e padisë nuk është më në fuqi pasi që në kohën e paraqitjes së padisë kontrata kolektive përkatëse nuk është më në fuqi edhe pse kontrata kolektive përkatëse nuk ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë detyrimet mbeten për kompensimin e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit për ditë e punës sa ka qenë kontrata kolektive në fuqi. Andaj, nga të gjitha të lartcekurat dhe bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata ka vlerësuar se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në pagave të 13-ta dhe se të njëjtat janë të legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e të paditurës.

Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 24.11.2023 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitën e nenit 449 dhe 452, të LPK-së, sipas të cilave paditësi i pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të përpilimin të padisë shumën prej 260.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 20.00€ gjithsejtë shumën prej 280.00 euro.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**C.2023:267604, me datë 18 shtator 2024**

**Gjyqtari**  
**Bekim Salihu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.